



Prishtinë, 25 nëntor 2016
Kodi i ZRRE-së: V_865_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-184);
- Nenin 4, nenin 5, nenin 13 par 1 dhe nenin 14 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2013 për Caqet e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë;
- Nenin 4 paragrafi 9, 10 dhe 11 të Rregullës për Skemën Mbështetëse;
- Vendimin nr. V-810-2016 dt. 19 maj 2016 për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë;
- Aplikacionin/Kërkesën për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga ERA, në Lokacionin Selac 1, ZK Selac, me kapacitet të instaluar prej 35 MW, në Komunën e Mitrovicës, të datës 14.07.2016 të shoqërisë "SOWI KOSOVO" L.L.C., me adresë: rruga "Mujo Ulqinaku" nr. 12 , 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, dhe
- Aplikacionin për Pranin në Skemën Mbështetëse;

në seancën e mbajtur me datë 25 nëntor 2016 nxori këtë:

V E N D I M

Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar

- I. **I lëshohet AUTORIZIMI PRELIMINAR** shoqërisë "SOWI KOSOVO" L.L.C., për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga ERA, në Lokacionin Selac 1, ZK Selac, **me kapacitet të instaluar prej 35 MW**, në Komunën e Mitrovicës, Republika e Kosovës.
- II. Aplikuesit "SOWI KOSOVO" L.L.C., do t'i lëshohet AUTORIZIMI FINAL për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Era, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenet 14 dhe 15 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe kërkesave tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.



- III. Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të fillojë ndërtimin e stabilimenteve të reja gjenerues, para se t'i plotësojë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pikën II. të këtij Vendimi.
- IV. Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar përcakton disponueshmërinë e caqeve si dhe pranimin e aplikuesit në skemën mbështetëse dhe garantimin automatik të tarifës nxitëse.
- V. Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar përcakton se aplikuesit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë elektrike me Furnizuesit publik në kohëzgjatje 12 (dymbëdhjetë) vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditësh para datës së fillimit të operimit gjenerues.
- VI. Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar lëshohet për periudhë një (1) vjeçare, brenda së cilës periudhë aplikuesi obligohet që ti plotësoi kërkesat sipas pikës II. të dispozitivit të këtij Vendimi, dhe me shkrim të kërkoj lëshimin e Autorizimit për ndërtim të stabilimenteve të reja gjeneruese.

Arsyetim

- ZRRE me datë 14.07.2016 nga shoqëria **"SOWI KOSOVO" L.L.C.**, ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga ERA, në Lokacionin Selac 1, ZK Selac, me kapacitet të instaluar prej **35 MW**, në Komunën e Mitrovicës, Republika e Kosovës.
 - ZRRE me datë 22.11.2016 nga shoqëria **SOWI KOSOVO" L.L.C.**, ka pranuar aplikacionin për pranim në skemën mbështetëse.
 - ZRRE, pas vlerësimit të kërkesave dhe dëshmive relevante të bashkangjitura aplikacionit, pranimit të dëshmive tjera plotësuese, të kërkuara nga ZRRE, ka konstatuar se shoqëria **SOWI KOSOVO" L.L.C.**, ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga ERA, në Lokacionin Selac 1, ZK Selac, **me kapacitet të instaluar prej 35 MW**, në Komunën e Mitrovicës. Gjithashtu ka vlerësuar edhe kërkesën për pranim në skemën mbështetëse, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- VII. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
 - VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Krenar Bujupi, U.D. kryesues

Arsim Janova, anëtar

Besim Sejfiqaj anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Mitrovicës
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së